



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

KPPP.nr. 981/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Gent Bekeri, në çështjen përmbartimore të kreditorit “Rroni Fer” SH.P.K, me NUI:810243668, me seli në Gjakovë, kundër debitorit “Alba Group” SH.P.K, me NUI:810829864, me seli në Prishtinë, Rr. “Musa Tolaj” Lam A/Hyrja-1/Kati 4, nr.3, të cilin me autorizim e përfaqëson Jupolli & Associates SH.P.K, me seli në Prishtinë, Rr. “Tirana”, Prime Group, C4/3, D-2/6, duke vendosur lidhur me kërkesën për kthim në gjendje të mëparshme dhe prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.259/21 të datës 29.04.2021, lejuar nga Përmbartuesi Privat Gjokë Radi me seli në Gjakovë, jashtë seancës me datën 19.10.2023, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET si e pabazuar kërkesa për kthim në gjendje të mëparshme e paraqitur nga debitori “Alba Group” SH.P.K, për shkak të humbjes së afatit për paraqitjen e Prapësimin ndaj Urdhrit Përmbartimor P.nr. 259/21 të datës 29.04.2021 të lejuar nga Përmbartuesi Privat Gjokë Radi.
- II. HEDHET si i pasafatshëm prapësimi i debitorit “Alba Group” SH.P.K , i paraqitur kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.259/21, të datës 29.04.2021, të lejuar nga Përmbartuesi Privat Gjokë Radi.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat Gjokë Radi duke vepruar sipas propozimit të kreditorit ka lëshuar Urdhrin Përmbartimor P.nr.259/21 të datës 29.04.2021, me të cilin ka lejuar përmbartimin në bazë

të faturës nr.24-09-19/04 e datës 24.09.2019, faturës nr.05-10-19/02 e datës 05.10.2019, faturës nr.24-09-19/01 e datës 24.09.2019, faturës nr.20-09-19/01 e datës 20.09.2019, faturës nr.18-09-19/01 e datës 18.09.2019 dhe faturës nr.08-08-17/01 e datës 08.08.2017, në shumë të përgjithshme prej 2,252.80 Euro, me kamatë ligjore nga dita e lejimit të përmbartimit deri në pagesën definitive dhe shpenzimet e përmbartimit, po ashtu ka urdhëruar debitorin që brenda afatit prej 7 ditësh nga dita e pranimit të urdhrin për përmbartim të bëjë pagesën e plotë të borxhit dhe shpenzimet e përmbartimore. Po qëse brenda afatit të dhënë, debitori nuk e bënë zbatimin e përmbartimit për shumën e plotë të borxhit, dhe shpenzimeve, përmbartimi ndaj debitorit zbatohet me bllokimin e llogarive rrjedhëse tek Bankat Komerciale në Kosovë dhe bartjen e mjeteve monetare në llogarinë e kreditorit. Nëse përmbartimi në llogaritë bankare të debitorit është i pa suksesshëm, përmbartimi të zbatohet me regjistrimin, vlerësimin dhe shitjen e pasurisë së luajtshme dhe të pa luajtshme që gjendet në posedim dhe pronësi të debitorëve deri në pagesën e plotë të borxhit, kamatës dhe shpenzimeve të përmbartimit

Debitori ka pranuar urdhrin për lejimin e përmbartimit me datë 05.05.2021, ndërsa me datë 27.05.2021 ka paraqitur kërkesën për kthimin e gjendjes së mëparshme për shkak të humbjes së afatit për paraqitjen e prapësimit, me arsyetim se Urdhri Përmbartimor është pranuar nga punëtori fizik i debitorit, dhe se ai vetëm e ka lënë plikon në zyrë pa e dorëzuar tek administrata, si rrjedhojë nuk mundur ta ruaj afatin e dhënë për prapësim sipas këshillës juridike.

Kërkesës për kthim në gjendje të mëparshme nuk ia ka bashkangjitur asnjë provë, ka theksuar se pretendimet e debitorit për refuzimin e përmbartimit janë shumë të qëndrueshme, dhe se sipas LPP-së, lejohet kthimi në gjendje të mëparshme për shkak të mos ruajtjes së afateve për prapësim, ka kërkuar nga gjykata që kërkesën ta aprovoj dhe të shqyrtoj prapësimin e parashtruar.

Gjykata pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, gjeti se kërkesa e debitorit për kthimin në gjendje të mëparshme për shkak të humbjes së afatit për paraqitjen e prapësimit është e pabazuar dhe rrjedhimisht prapësimi i debitorit është i pasafatshëm për shkaqet si në vijim:

Gjykata fillimisht konstatoj se debitori ka pranuar urdhrin për lejimin e përmbartimit me datë 05.05.2021, fakt ky që vërtetohet nga flete dërgesa për dorëzim personal pjesë e shkresave të lëndës, urdhri i lartcekur përmban nënshkrimin e marrësit.

Andaj, në kuptim të nenit 104, par.1 të LPK-së me të cilin parashihet se *“Dërgimi organeve shtetërore dhe personave juridik u bëhet duke iu dorëzuar shkresat personit të autorizuar për pranimin e tyre apo të punësuarit që gjendet në zyrën, gjegjësisht në lokalitë e punës”*, rezulton se Përmbartuesi Privat, e ka dorëzuar Urdhrit Përmbartimor në zyrën e debitorit, ndërsa mjetin juridik të prapësimit debitorit e ka ushtruar me datë 27.05.2021 pas 22 ditë nga dita e pranimit të urdhrit përmbartimor.

Sipas dispozitës ligjore të nenit 129 par.1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), parashihet se: *“në qoftë se pala nuk shkon në seancë fare apo e humb afatin për kryerjen e ndonjë veprimi procedural dhe për këtë shkak e humb të drejtën që më vonë të kryej veprimin procedural të lidhur me afat, gjykata do t’i lejojë kësaj pale, me propozimin e saj të kryej me vonë këtë veprim, po që se konstaton se ekzistojnë shkaqe të arsyeshme të cilat nuk kanë mundur të parashikohen e as të evitohen”*.

Nga të lartcekurat Gjykata vlerëson se në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me ndonjë shkak të arsyeshëm si rezultat i të cilit i është pamundësuar debitorit që ta ushtroj prapësimin brenda afatit ligjor ndaj Urdhrit Përmbartimor P.nr. 259/21 të datës 29.04.2021 meqenëse urdhri për lejimin e përmbartimit është dorëzuar në mënyrë të rregullt tek debitorit, ndërsa debitorit nuk ka ofruar asnjë provë nga e cila dëshmohet se ka ekzistuar ndonjë shkak i arsyeshëm për mos paraqitjen e prapësimit brenda afatit ligjor, andaj edhe gjykata vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktvendimi duke refuzuar kërkesën për kthim në gjendje të mëparshme si të pabazuar.

Në këtë drejtim, meqenëse dorëzimi i Urdhrit Përmbartimor është konsideruar i rregullt dhe është pranuar me datë 05.05.2021, ndërsa kërkesa për kthim në gjendje të mëparshme e parashtruar nga debitorit doli të jetë e pabazuar, rezulton se debitor ka mundur ta ushtroj mjetin juridik të prapësimit jo më vonë se me datë 12.05.2021 kjo në kuptim të nenit 70 të LPP-së me të cilin përcaktohet se *“Prapësimi duhet t’i paraqitet Gjykatës brenda shtatë (7) ditëve pas pranimit të vendimit përmbartues ose urdhrit përmbartues”* kurse i njëjti, ka paraqitur prapësimin me vonesë, pra me datë 09.06.2021.

Mbi këtë bazë, e në kuptim të nenit 73, par. 3 të LPP-së me të cilin përcaktohet se *“Me vendim prapësimi mund të pranohet, refuzohet ose hidhet poshtë si i pa afatshëm, si jo komplet*

dhe i palejuar” Gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij Aktvendimi duke e hedhur prapësimin si të pasafatshëm.

Bazuar në të lartcekurat, e në kuptim të nenit, 129, 130 dhe nenit 133.4 të LPK-së, e në lidhje me nenin 68.2 të LPP-së dhe nenit 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.981/22, datë 19.10.2023

Gjyqtari

Gent Bekeri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimin të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.